

2023

1st Health CONGRESS

5-6-7
March
ALBANIA

- ▶ Better Care
- ▶ Better Quality
- ▶ More Innovation

UBF merr pjesë në Kongresin e Shëndetësisë, Mars 2023

Në 8 Mars 2023, në kuadër të zhvillimeve të punimeve të kongresit të shëndetësisë, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shoqata UBF mori pjesë në sesionin e 10-të organizuar për farmaceutikën me temën **“Siguria dhe cilësia e barnave, aksesit i rritur dhe mundësia e aksesit për barna inovatore”**.

Ilir Minga, si përfaqësues i shoqatës UBF bëri një prezantim të situatës farmaceutike në vend, duke u fokusuar te distribucioni në vecanti. Ai theksoi rëndësinë e modelit të distribucionit që duhet bazuar jo vetëm te kriteri i konkurrencës tregtare, por te shërbimi. “Në vlerën e barit, kostot e distribucionit janë shumë të vogla krahasuar me koston e barit dhe shërbimit. Pesha financiare në këtë shërbim inicohet me investim nga vetë kompanitë distributore, të cilat në një farë mënyrë, kreditojnë shërbimin.”

Më pas Z. Minga u ndal te sfidat e përditshme të distributorëve në Shqipëri dhe në disa problematika që lidhen me sigurimin e cilësisë, aksesin e hershëm të pacientëve në terapi inovatore, adresimin e produkteve të munguara, rëndësinë në rritje të ESG-së (Udhëheqje mjedisore, sociale e korporative) dhe në përmirësimin e sigurisë së furnizimit.

Gjithashtu, z. Minga parashtroi disa nga çështjet e ngritura në takimet e shpeshta të anëtarëve të shoqatës, konkretisht, rishikimi i DST-ve që kontratat të jenë më të zbatueshme, rivlerësimi i metodologjisë së vlerësimit të cmimeve dhe VKM përkatëse, të përshtatet si duhet rregullorja e dhënies së autorizimit për tregtim sipas BE-së dhe hartimi i një rregulloreje lokale (sipas udhërrëfyesit evropian) për frekuencën dhe mënyrën e raportimit.

Si konkluzion, z. Minga tërhoqi vëmendjen se kostot e distribucionit po rriten. Hedhja në treg e produkteve të reja bëhet me rrjetin ekzistues pa shfrytëzuar MEA-n, teksa pranoi se shpesh marrëdhëniet midis distributorëve janë taktike dhe jo strategjike. Ai gjithashtu, theksoi se UBF do të vijojë punën me të gjithë aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për përmirësimin e kushteve të tregut në funksion të një shoqërie të shëndetshme, aksesit të barnave inovatore dhe cmime të përballueshme për qytetarët.